



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 683

Prishtinë, Dt. 28.02.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji / Ekologji-Mbrojtje e mjedisit
Projektpropozimi	"Flora vaskulare përgjatë rrjedhës së lumit Drenicë (Karaçicë-Shtrubullojë)" / "Vascular flora along the flow of the Drenica river (Karaçicë-Shtrubullojë)"
Kandidati	Rozeta Tahiri
Mentori	Prof. Dr. Elez Krasniqi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 07.07.2023 Vendimi nr.: 3266
<b>Vlerësimi i dorëshkrimit</b>  <b>Shënimet e përgjithshme</b> Punimi i Masterit i kandidatës <b>Rozeta Tahiri</b> ka 64 faqe tekst me rrallim normal. Përmban 3 tabela dhe 29 figura. Në punim janë cituar 51 burime të literaturës. Punimi ka abstrakt dhe rezyme në gjuhën shqipe e angleze. Në fund të punimit është dhe jetëshkrimi i kandidatës. Punimi i Masterit përmban kapitujt: <b>Hyrje</b> (faqe 11-13), <b>Qëllimi dhe rëndësia e punimit</b> (faqe 14), <b>Të dhëna të përgjithshme për terrenin e hulumtuar</b> (faqe 15-18), <b>Ndikimi i faktorit antropogjen</b> (faqe 19), <b>Njohuri të përgjithshme për florën dhe vegjetacionin përgjatë rrjedhës së lumit Drenicë (Karaçicë-Shtrubullojë)</b> (faqe 20-21), <b>Materiali dhe metodat e punës</b> (faqe 22-23), <b>Rezultatet e hulumtimit</b> (faqe 24-50), <b>Diskutim</b> (faqe 51-52), <b>Përfundime</b> (faqe 53), <b>Literatura</b> (faqe 54-57), <b>Rezyme</b> (faqe 58-60), <b>Summary</b> (faqe 61-63). Në fund të punimit është <b>Jetëshkrimi</b> (faqe 64).	

### **Analiza e Punimit**

Në **Hyrje** kandidatja analizon të dhëna përgjithësuara për Kosovën sa i përket rrjedhave ujore duke u bazuar nga literatura dhe nga rezultatet në terren. Përshkrimi i të dhënave vazhdohet me të dhënat e deritanishme të hulumtimeve nga flora dhe vegjetacioni në nivel vendi, duke u fokusuar edhe në të dhëna të përgjithshme për pjesën e hulumtuar të lumit Drenicë (Karaçicë-Shtrubullojë).

Në kapitullin **“Qëllimi dhe rëndësia e punimit”** arsyetohet punimi, arritja e qëllimit si dhe rëndësia e tij.

Në kapitulli: **“Të dhëna të përgjithshme për terrenin e hulumtuar”** duke u bazuar nga literatura por edhe nga gjendja në terren, prezantohen të dhëna për pozitën gjeografike, përbërjes pedologjike si dhe kushtet klimatike përgjatë rrjedhës së lumit Drenicë në pjesën e hulumtuar.

Në kapitullin: **“Ndikimi i faktorit antropogjen”** prezantohen veprimet e faktorit antropogjen përgjatë rrjedhës së lumit Drenicë (në pjesën e hulumtuar).

Prezantimi i të dhënave të përgjithshme për florën dhe vegjetacionin e zonës së hulumtuar arrihet në kapitullin **“Njohuri të përgjithshme për florën dhe vegjetacionin përgjatë rrjedhës së lumit Drenicë (Karaçicë-Shtrubullojë)”**.

**Materiali dhe metodat e punës** përshkruhen në veçanti.

**Rezultatet e hulumtimit** si kapitull në qendër të punimit, paraqet rezultatet e arritura të punës hulumtuese, ku prezantohen llojet e konstatuara nga flora vaskulare përgjatë rrjedhës së lumit Drenicë (Karaçicë-Shtrubullojë). Renditja e grupeve të larta sistematike (Tipet dhe Klasët) janë realizuar sipas filogjenisë, përderisa radhitja e familjeve, gjinive dhe e llojeve është alfabetike. **Analiza e formave korologjike dhe analiza e formave jetësore** prezantohen gjithashtu të veçuara.

**Diskutimi dhe përfundimet** pasqyrojnë realitetin e gjendjes së florës në terren, ndërsa prezantohen të veçuara.

**Literatura** e cituar është e kohës dhe aktuale dhe e duhur për përcjelljen e zhvillimeve nga flora vaskulare.

### **Vlerësimi dhe propozimi**

Punimi i masterit i kandidatës **Rozeta Tahiri** është hulumtim i mirëfilltë floristik. Rezultatet e punimit janë arritur pas punës hulumtuese në terren gjatë vitit 2023. Rezultate e prezantuara në këtë punim janë të rëndësishme për plotësimin florës vaskulare të Republikës së Kosovës.

Prandaj, komisioni e vlerëson pozitivisht Punimin e masterit të kandidatës **Rozeta Tahiri**, me titull **“Flora vaskulare përgjatë rrjedhës së lumit Drenicë (Karaçicë-Shtrubullojë)” / “Vascular flora along the flow of the Drenica river (Karaçicë-Shtrubullojë)”**. Komisioni për vlerësimin e këtij dorëshkrimi i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Departamentit të Biologjisë si dhe Këshillit

Mësimor-Shkencor të FSHMN-së që punimin në fjalë ta pranojë dhe të formoj Komisionin për mbrojtje publike të Punimit të Masterit me qëllim të arritjes së titullit: Master i Shkencave të Biologjisë (Programi: Ekologji-Mbrojtje e mjedisit).

Prishtinë, 27.02.2024

Komisioni:

1.  \_\_\_\_\_

/ Prof. Dr. Fadil Millaku – kryetar/

2.  \_\_\_\_\_

/ Prof. Dr. Elez Krasniqi – anëtar (mentor)

3.  \_\_\_\_\_

/ Prof. Assoc. Dr. Bekim Gashi – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.